



BASHKIA E TIRANËS

Nr. prot. 22289

Tiranë 27/12 / 2015

Drejtuar: Z. Aldrin Dalipi
Kryetar
Këshilli Bashkiak i Tiranës


Lënda : Dërgohet material për shqyrtim e miratim

I nderuar z. Dalipi,


Bashkëlidhur ju dërgojmë për shqyrtim e miratim relacionin dhe projekt-vendimin për “Miratimin e termave kryesore të kontratës koncesionare mbi parkimin nëntokësor në parkun “Rinia”.

Me respekt

K R Y E T A R I



Erion Veliaj





BASHKIA E TIRANËS

RELACION

Mbi

“Miratimin e termave kryesore të kontratës koncesionare mbi parkimin nëntokësor në parkun “Rinia”

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, nenit 10, pika 3/1, shkronjat “d” dhe “ë”, nenit 32, shkronjat “e”, “f” dhe “k” dhe nenit 33, pikat 3 dhe 4 të Ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); nenit 48 të Ligjit nr. 125/2013, datë 25.04.2013 për “Koncesionet dhe partneritetin publik privat” (i ndryshuar); Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 për “Menaxhimin finaciar dhe kontrollin”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1181, datë 23.07.2008 për “Përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion vendor të parkimit nëntokësor, në parkun “Rinia”, Tiranë, dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 834, datë 13.12.2006 “Për miratimin e listës së pjeshme të inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të Bashkisë Tiranë të qarkut të Tiranës”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 798, datë 30.9.2015 “Për shfuqizimin e vendimit nr. 1233, datë 11.12.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit të sipërfaqes së truallit të parkut “Rinia”, Tiranë”; udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 për “Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” (i ndryshuar); Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 36, datë 29.09.2008 për “Përcaktimin e formës së dhënies me koncesion të dy parkimeve nëntokësore në qytetin e Tiranës”; Raportin Përmbledhës me nr.prot.4663, datë 20.05.2009, mbi “Vlerësimin e ofertave për “Dhënien me koncesion vendor të parkimit nëntokësor në parkun “Rinia”, Tiranë”; shkresës nr.prot.4207, datë 06.05.2009, të Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, drejtuar shoqërisë “Taiwan” shpk, për “Njoftim mbi vlerësimin dhe klasifikimin e shoqërisë”, i paraqesim Këshillit Bashkiak materialin sa më poshtë:

Bashkia e Tiranës, në kuadër të zhvillimit të qëndrueshem të kryeqytetit dhe strategjisë së transportit dhe lëvizshmërisë, ka identifikuar nevojat e mëdha aktuale dhe të së ardhmes për parkim dhe në këtë kuadër ka hartuar plane, me qëllim zbatimin e një politike të qartë të transportit lokal, politikë, e cila është e lidhur me gjendjen sociale dhe lëvizshmërinë, duke synuar një mjedis të jetueshëm urban.

Parkimi, si në rrugë ashtu edhe jashtë-rruge është një aspekt i rëndësishëm dhe shumë kritik për një qytet, veçanërisht për një qytet qendër të aktiviteteve sociale dhe ekonomike si Tirana. Parkimi në një qytet u lejon vizitorëve të frekuentojnë biznese dhe pjesë të tjera të qytetit, ndërsa rezidentëve të qytetit u krijon mundësi që të planifikojnë shpërndarjen e tyre në aktivitetet sociale dhe ekonomike. Gjithashtu, ai është i nevojshëm për të inkurajuar dhe kënaqur rezidentët e tij duke ju bërë të aksesueshme aktivitetet tregtare, sociale etj. Megjithatë, parkimi është një çështje e komplikuar dhe e shumëanshme, i cili ka një impakt të drejtpërdrejtë mbi transportin urban dhe atë rajonal, mobilitetin, aksesin, zhvillimin, cilësinë e mjedisit dhe përdorimin e hapësirës urbane. Strategjia e Transportit në qytetin e Tiranës është e lidhur ngushtësisht me parkimin në dhe jashtë rrugës, ku politika e vendosur mund të luajë një rol rregullator duke inkurajuar komunitetin të përdorë transportin publik apo atë privat,

faktorë të cilët luajnë një rol të rëndësishëm në trafikun e qytetit. Në lidhje me ndërtimin e parkimeve nëntokësore në qytetin e Tiranës në planet rregulluese të miratuara janë parashikuar disa të tillë.

Konkretisht parkimet nëntokësore në parkun "Rinia" dhe në sheshin "Italia", janë miratuar dhe janë në përputhje me vendimin e KRRT-së së Bashkisë Tiranë nr. 244, datë 15.04.2004 për "Studimin urbanistik të qendrës së Tiranës "Tirana një kryeqytet europian", miratuar me vendimin e KRRTRSH-së nr.1, datë 27.4.2004 për "Miratimin e Studimit Urbanistik të Qendrës së Qytetit të Tiranës".

Plani Francez "Architecture Studio" e miratuar me vendimin e KRRT-së së Bashkisë Tiranës nr. 244, datë 15.04.2004 për "Studimin urbanistik të qendrës së Tiranës "Tirana një kryeqytet europian", miratuar me vendimin e KRRTRSH-së nr.1, datë 27.4.2004 për "Miratimin e Studimit Urbanistik të Qendrës së Qytetit të Tiranës" parashikon parkim nëntokësor te:

- parku "Rinia" në pjesën veriore (përgjatë rruges "Myslym Shyri");
- sheshi "Italia".

Këto parkime nëntokësore janë parashikuar edhe në Planin e Përgjithshëm Rregullues të Tiranës miratuar me vendimin nr.1, datë 15.02.2013, të KKT. Në këtë vendim janë parashikuar edhe parkime të tjera nëntokësore të renditura nga Veriu-Jug si më poshtë:

- Stacioni i Trenit
- Blloku i banimit pas ish kafe "Flores" (rr. Durrësit – rr. Mine Peza)
- "Pylli" mes Bankës dhe Muzeut Kombëtar
- Lulishtja pas "Pallatit të Kulturës"
- Sheshi "Avni Rustemi"
- Parku "Rinia"
- Sheshi te "Vëllezërit Frashëri" pranë kullave binjake
- Lulishtja pas Kryeministrit
- Lulishtja te monumenti i diktaturës (bunkerit; busti Ismail Qemalit)
- Hapësira në lindje të stadiumit "Qemal Stafa"
- Sheshi "Italia"

Marrëdhënia midis kërkesës dhe ofertës për parkim është një nga çështjet kryesore që shtrohet për t'u zgjidhur. p.sh. mungesa e kapaciteteve të parkimit (në dhe jashtë-rrugës) në hapësirat e bizneseve në qytet, mund të vonojë rritjen ekonomike të qytetit, mund të krijojë stres tek shoferët, të cilët kërkojnë parkim dhe mund të rezultojë me humbje të produktivitetit. Një ofertë e madhe parkimi, mund të rrisë numrin e makinave që hyjnë në qytet, duke reduktuar përdorimin e transportit publik, duke sjellë si rezultat impakt negativ në mjedis, në mënyrën e jetesës për qytetarët, ashtu dhe në rritjen e ngarkesës së rrugëve kryesore të qytetit.

Parkimi me kohë të gjatë pa asnjë rregullim në hapësira rezidenciale, mund të sjellë si pasojë që vetë rezidentët të gjejnë parkim diku tjetër, larg shtëpisë së tyre drejt vendeve të tjera duke zënë hapësira gjatë ditës. Veç kësaj, mos rregullim i mirë i sistemit të gjobave për parkimin e gabuar, inkurajojnë shoferët për parkime ilegale dhe përdoruesit e makinave të braktisin transportin publik. Bashkia e Tiranës në zgjidhje të problematikave të sipërpërmendura ka bërë të mundur hartimin e një politike parkimi, e cila është miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 48, datë 11.11.2015 për "Krijimin e Tirana Parking si institucion në varësi të Bashkisë Tiranë për administrimit e shërbimit të parkimit publik me pagesë" dhe Vendimit nr.

49, datë 11.11.2015, për “Miratimin e kritereve të përcaktimit të zonave të administrimit të parkimit dhe nënzonave të destinuara për parkim, si dhe tarifave të shërbimit të parkimit të administruara nga Bashkia e Tiranës”.

Nga eksperiencia në Evropë dhe në botë, është e qartë që planifikimi i ekuilibruar dhe parashikimi, nevojiten në veprimtarinë dhe menaxhimin e parkimit në çdo qytet. Me qëllim zbatimin e kësaj strategjie transporti dhe zgjidhjen e problematikës së parkimit Bashkia e Tiranës në vitet 2008 dhe 2009, zhvilloi procedurat për përcaktimin dhe përzgjedhjen e subjekteve për realizimin e parkimeve nëntokësore, bazuar në legjislacionin në fuqi për koncesionet dhe prokurimin publik.

Pas këshillimeve me Agjensinë e Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO), si dhe në vijim të ndjekjes së procedurave ligjore për shqyrtimin e propozimeve të pakërkuara Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 1181, datë 23.07.2008 për “Përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion vendor të parkimit nëntokësor, në parkun “Rinia”, Tiranë, dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë”, përcaktoi Bashkinë e Tiranës si autoritet kontraktues për dhënien e këtij koncesioni. Në vijim të vendimit të mësipërm të Këshillit të Ministrave, Këshilli Bashkiak Tiranë me vendimin nr. 36, datë 29.09.2008 për “Përcaktimin e formës së dhënies me koncesion të dy parkimeve nëntokësore në qytetin e Tiranës”, miratoi:

- Lloji i koncesionit të dy parkimeve nëntokësore në Parkun “Rinia” dhe në Sheshin “Italia” pranë stadiumit “Qemal Stafa” në qytetin e Tiranës, do të jetë i formës BOT (ndërtim, operim dhe transferim). Ngarkimin e Kryetarit të Bashkisë së Tiranës për ndjekjen e mëtejshme të procedurave ligjore koncesionare.

Në zbatim të këtij vendimi të Këshillit Bashkiak, në përputhje me përcaktimet e kuadrit ligjor në fuqi, u miratuan disa akte të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, si më poshtë:

- Urdhri nr. 1304, datë 24.10.2008, mbi “Nisjen e procedurave konkurruese, për dhënien me koncesion të dy parkimeve nëntokësore në qytetin e Tiranës”;
- Urdhri nr. 1308, datë 28.10.2008, mbi “Ngritjen e Njesisë së Hartimit të Dokumenteve, për dhënien me koncesion të parkimeve nëntokësore në qytetin e Tiranës”;
- Urdhri nr. 1335, datë 31.10.2008 mbi “Ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për dhënien me koncesion të dy parkimeve nëntokësore në qytetin e Tiranës”.

Për parkimin nëntokësor në Parkun “Rinia”, Bashkia e Tiranës i dërgoi subjektit “Taiëan” shpk njoftimin e ftesës për ofertë me nr. prot. 1359, datë 10.02.2009. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, i ngritur me urdhrin nr. 1335, datë 31.10.2008 mbi “Ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për dhënien me koncesion të dy parkimeve nëntokësore në qytetin e Tiranës”, me anë të Raportit përmbledhës mbi vlerësimin e ofertave për “Dhënie me koncesion të parkimit nëntokësor në Parkun “Rinia”, Tiranë” me nr. prot.4643, datë 20.05.2009, në zbatim të legjislacionit në fushën e koncesionit, si dhe në Dokumentet Standarte të Procedurës Konkurruese, vendosi:

- Të klasifikojë shoqërinë “Taiwan” sh.p.k si ofertë të vetme, me shumën totale të pikëve prej 101 (njëqind e një) pikë.
- Të njoftojë shoqërinë pjesëmarrëse për vlerësimin dhe klasifikimin.
- Ti propozojë titullarit të Autoritetit Kontraktues shpalljen fitues, të procedurës konkurruese për “Dhënie me koncesion vendor të parkimit nëntokësor në parkun “Rinia”, Tiranë, shoqërinë “Taiwan” sh.p.k.

Ky subjekt, ka paraqitur në mënyrë të përmbledhur këtë ofertë:

NR.	KRITERET	OFERTA
1	STANDARTI I PROPOZUAR I NDERTIMIT DHE FUNKSIONIMIT TE VEPRES	N/A
2	TARIFA E PARKIMIT	ORA 1 120 lekë/orë ORA 2-4 50 lekë/ 30 min ORA 4-8 40 lekë/ 30 min ORA 8-12 40 lekë/ 30 min Biletë ditore 850 lekë Biletë nate 22-07 500 lekë Biletë mujore 12.000 lekë Biletë 3 mujore 34.000 lekë Biletë 6 mujore 60.000 lekë
3	TARIFA KONCESIONARE	10% e fitimit
	EFEKTSHMERIA OPERACIONALE, DETAJUAR SI MEPOSHTE	
	NUMRI MAKSIMAL I VENDPARKIMEVE TOTAL	1342
	NUMRI MAKSIMAL I VENDPARKIMEVE PËR KATEGORI TE VECANTA	Invalide 30 vende Institucionet publike 140 vende Rezidentë 160 vende Biznesi 73 vende
4	TARIFAT E PASACME E PARKIMIT PER KATEGORI TË VECANTA	Invalide falas Institucione publike 6.000 lekë/ muaj Rezidentë 10.000 lekë/ muaj Biznesi 12.000 lekë/ muaj
5	PËRPUTHSHMËRIA ME STANDARTE MJEDISORE	N/A
6	CILËSIA E SHËRBIMEVE DHE MASAT PËR TË SIGURUAR VAZHDIMËSINË E TYRE	N/A
7	KOHA E VËNIES NË SHFRYTËZIM TË VEPRËS	15 muaj
8	KOHËZGJATJA E KONCESIONIT	35 vjet
9	VLERA E INVESTIMIT	1.937.932.800lekë
10	POTENCIALI I ZHVILLIMIT SHOQËROR DHE EKONOMIK QË OFROHET NGA PROPOZIMET	N/A

- Subjekti I mësipërm u shpall fitues dhe u njoftuan me shkresë të Kryetarit të Bashkisë Tiranë nr. 4207, datë 06.05.2009.
- Subjekti i shpallur fitues për procedurat konkurruese, u ftua nga Kryetari i Bashkisë Tiranë për negocimin përfundimtar të kontratës koncesionare.


Procedura e sipërpërmendur nuk arriti të përfundohet, për arsye se me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1233, datë 11.12.2009 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit të sipërfaqes së truallit të parkut “Rinia”, Tiranë, prona objekt i koncesionit në fjalë nuk ishte më pjesë e pronave të administruara nga

Bashkia Tiranë, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 834, datë 13.12.2006 “Për miratimin e listës së pjesshme të inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të Bashkisë Tiranë të qarkut të Tiranës”. Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 798, datë 30.9.2015 “Për shfuqizimin e vendimit nr. 1233, datë 11.12.2009, të Këshillit të Ministrave “Për kalimin në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit të sipërfaqes së truallit të parkut “Rinia”, Tiranë”, kjo pronë është sërish pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore që janë nën juridiksionin territorial dhe administrativ të Bashkisë Tiranë, dhe kështu mund të vijohet me përfundimin e procedurës për dhënien me koncesion të parkimit publik në Parkun “Rinia”.


Me anë të shkresës nr. 22257, datë 23.12.2015, Bashkia e Tiranës i ka kërkuar Shoqërisë “Taiwan” sh.p.k të shprehë qëndrimin në lidhje me vijimin e procedurave për koncesionin e parkimit nëntokësor në Parkun “Rinia”, Tiranë.

Sa më sipër, Kryetari i Bashkisë i drejtohet Këshillit Bashkiak të Tiranës për miratimin e termave kryesore të kontratës koncesionare, mbi parkimin nëntokësor në parkun “Rinia”.

Duke shpresuar në miratimin nga ana Juaj.

Drilona Aliko 
Specialist i Sektorit të Asistencës Ligjore dhe Legjislacionit

Raif Halidini 
Specialist i Sektorit të Rregjistrimit dhe Inventarizimit

Itena Ndroqi
Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licensimit 

Devis Agaraj
Përgjegjës i Sektorit të Makroplanifikimit

Gjergj Bakallbashi 
Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit të Territorit

Elona Shkoza 
Përgjegjëse e Sektorit të Prokurimeve Administrative

Matilda Memlika 
Specialiste e Sektorit të Planifikimit dhe Menaxhimit Urban

Gentian Nechvatal 
Përgjegjës i Sektorit të Infrastrukturës së Trafikut

Taulant Tusha
Drejtore i Drejtorisë së Përgjithshme të Punëve Publike

Arli Naska 
Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore

Jonida Halili (drejtor i deleguar)
Drejtore i Deleguar i Drejtorisë së Përgjithshme të Menaxhimit Financiar

Arbian Mazniku
Nënkryetar

Behar Zeneli
Sekretar i Këshillit Bashkiak

Arsela Gjonaj
Jurist i Këshillit Bashkiak



**BASHKIA E TIRANËS
KËSHILLI BASHKIAK**

Vendim (Projekt)

Nr. _____ datë _____ 2015

Mbi

“Miratimin e termave kryesore të kontratës koncesionare mbi parkimin nëntokësor në parkun “Rinia””

Në mbështetje të të nenit 7, pika 2, nenit 10, pika 3/l, shkronjat “d” dhe “ë”, nenit 32, shkronjat “e”, “f” dhe “k” dhe nenit 33, pikat 3 dhe 4 të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); nenit 48 të ligjit nr. 125/2013, datë 25.04.2013 për “Koncesionet dhe partneritetin publik privat” (i ndryshuar); ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 për “Menaxhimin finaciar dhe kontrollin”; vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1181, datë 23.07.2008 për “Përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion vendor të parkimit nëntokësor, në parkun “Rinia”, Tiranë, dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë”; vendimit të Këshillit të Ministrave nr.834, datë 13.12.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së pjesshme të inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të Bashkisë Tiranë të qarkut të Tiranës”; vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 798, datë 30.9.2015 “Për shfuqizimin e vendimit nr. 1233, datë 11.12.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit të sipërfaqes së truallit të parkut “Rinia”, Tiranë”; udhëzimit të Ministrit të Financave nr.30, datë 27.12.2011 për “Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” (i ndryshuar); vendimit të Këshillit Bashkiak nr.36, datë 29.09.2008 për “Përcaktimin e formës së dhënies me koncesion të dy parkimeve nëntokësore në qytetin e Tiranës”; Raportin Përmbledhës me nr.prot.4663, datë 20.05.2009, mbi “Vlerësimin e ofertave për “Dhënien me koncesion vendor të parkimit nëntokësor në parkun “Rinia”, Tiranë”; shkresës nr.prot.4207, datë 06.05.2009, të Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, drejtuar shoqërisë “Taiwan” shpk, për “Njoftim mbi vlerësimin dhe klasifikimin e shoqërisë”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak Tiranë.

VENDOSI:

1. Të miratojë termat kryesore të kontratës koncesionare për parkimin nëntokësor në Parkun “Rinia”, i cili do të realizohet nga koncesionari, shoqëria “Taiwan” shpk, sipas aneksit nr.1 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Koncesionari do të realizojë punimet mbi bazën e kontratës koncesionare dhe sipas procedurave ligjore në fuqi për planifikimin e territorit, tek Parku “Rinia”, me numër pasurie 7/187, në zonën kadastrale nr. 8380.

3. Koncesionari detyrohet që, pas ndërtimit të objektit dhe përpara fillimit të operimit të shërbimit, të realizojë punimet që të kthejnë mbitokën në destinacionin aktual, përkatësisht në park.
4. Koncesionari ndalohet të kolateralizojë për efekt financimi të investimit dhe shërbimit, truallin dhe objektin ndërtimor, pasuri të cilat mbeten të lira nga çdo barrë dhe risk përgjatë periudhës koncesionare.
5. Të kryhet kontabilizimi i vlerave të investimeve përkatësisht për Parkun "Rinia", me numër pasurie 7/187, në zonën kadastrale nr. 8380. Të reflektohen ndryshimet kontabël duke zbritur vetëm vlerat përkatëse të investimeve që rezultojnë brenda sipërfaqes, që do të jepet me koncesion dhe do të ndjekë procedurat ligjore për dorëzimin e saj ndaj koncesionarit. Me përfundimin e ndërtimit të parkimit nëntokësor dhe rikthimin në destinacionin aktual të sipërfaqes së mbitokës, koncesionari do bëjë kalimin e vlerave përkatëse kontabël Bashkisë së Tiranës.
6. Koncesionari në përfundim të Kontratës Koncesionare, i kalon Bashkisë së Tiranës pronën sipas genplanit bashkëlidhur.
7. Autorizohet Kryetari i Bashkisë Tiranë të nënshkruaje kontratën koncesionare sipas përcaktimeve të këtij vendimi dhe procedurave ligjore.
8. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen strukturat e Bashkisë së Tiranës.
9. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Kryetari

Aldrin Dalipi

Aneksi 1.

**TARIFAT REFERENCË TË PARKIMEVE NËNTOKËSORE SI DHE P AJTIMET
PERIODIKE
Për subjektin "Taiëan"
Parku "Rinia"**

NR.	KRITERET	OFERTA
1	STANDARTI I PROPOZUAR I NDERTIMIT DHE FUNKSIONIMIT TE VEPRES	N/A
2	TARIFA E PARKIMIT	ORA I 120 lekë/orë ORA 2-4 50 lekë/30 min ORA 4-8 40 lekë/30 min ORA 8-12 40 lekë/30 min Biletë ditore 850 lekë Biletë nate 22-07 500 lekë Biletë mujore 12.000 lekë Biletë 3 mujore 34.000 lekë Biletë 6 mujore 60.000 lekë
3	TARIFA KONCESIONARE	10% e fitimit
	EFEKTSHMERIA OPERACIONALE, DETAJUAR SI MEPOSHTE	
	NUMRI MAKSIMAL I VENDPARKIMEVE TOTAL	1342
	NUMRI MAKSIMAL I VENDPARKIMEVE PËR KATEGORI TE VECANTA	Invalidët 30 vende Institucionet publike 140 vende Rezidentë 160 vende Biznesi 73 vende
4	TARIFAT E PASACME E PARKIMIT PER KATEGORI TË VECANTA	Invalidët falas Inistitucione publike 6.000 lekë/ muaj Rezidentë 10.000 lekë/ muaj Biznesi 12.000 lekë/ muaj
5	PËRPUTHSHMËRIA ME STANDARTE MJEDISORE	N/A
6	CILËSIA E SHËRBIMEVE DHE MASAT PËR TË SIGURUAR VAZHDIMËSINË E TYRE	N/A
7	KOHA E VËNIES NË SHFRYTËZIM TË VEPRËS	15 muaj
8	KOHËZGJATJA E KONCESIONIT	35 vjet
9	VLERA E INVESTIMIT	1.937.932.800 lekë
10	POTENCIALI I ZHVILLIMIT SHOQËROR DHE EKONOMIK QË OFROHET NGA PROPOZIMET	N/A